|  |   |  | lekë                 | 10,106,676                      | 14,500,000                                     | 14,500,000                                       | 12,292,849                          | 2,207,151                      | 85                    |
| M290057  | Rikonstrukcion ndertimi   |  | Numer institucioni   |                                 | 1  | 1  | 1                                   | 0                              | 100                   |
|  |   |  | lekë                 | 0                               | 500,000  | 500,000  | 495,495                             | 4,505                          | 99                    |

|   |       |               |                          |       |             |
|---|-------|---------------|--------------------------|-------|-------------|
| Drejtuasi i Ekipit Menaxhues të Programit | Emri  | Arjan Parruca | Sekretari i Përgjithshëm | Emri  | Rudin Baqli |
|   | Firma |               |                          | Firma |             |
|   | Data  | 22.02.2024    |                          | Data  | 22.02.2024  |

**ANEKSI nr.4 Raporti i realizimit të treguesve të performances së programit**

**Periudha e Raportimit 12-2023**

|  |  |   |                           |  |  |  |                                      |                                |                       |
|--|--|---|---------------------------|--|--|--|--------------------------------------|--------------------------------|-----------------------|
| <b>Emri i Grupit</b>                             |  | <b>Këshilli i Lartë Gjyqësor</b>  |                           |  | <b>Kodi i Grupit</b>                           |  |                                      | <b>29</b>                      |                       |
| <b>Emri i Programit</b>                          |  | <b>Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë</b>   |                           |  | <b>Kodi i Programit</b>                        |  |                                      | <b>01140</b>                   |                       |
| <b>Qëllimi i politikës së programit</b>          |  | Percaktimi i prioriteteve, politikave dhe standarteve, ne lidhje me sistemet e teknologjise se informacionit, ne sistemin e drejtesise. |                           |  |  |  |                                      |                                |                       |
| <b>Treguesit e performancës në nivel qëllimi</b> |  |   |                           | <b>Treguesit e performancës/Produktet:</b> |  |  |                                      |                                |                       |
| <b>Kodi i treguesit</b>                          | <b>Emërtimi i treguesit</b>  | <b>Tregues me bazë gjinore (PO)</b>   | <b>Njësia matese</b>      | <b>Fakti i Vitit Paraardhës</b>            | <b>Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023</b> | <b>Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023</b> | <b>Fakti i Periudhës/progressive</b> | <b>Ndryshimi (Plan - Fakt)</b> | <b>% e realizimit</b> |
|  | Permiresimi i sistemeve te teknologjise se informacionit ne sistemin e drejtesise.                                 |   |                           | 65   |  |  | 50                                   |                                |                       |
| <b>Objektivat e politikës së programit</b>       |  |   |                           |  |  |  |                                      |                                |                       |
| <b>Objektivi</b>                                 | Angazihimi i QTI per garantimin e arritjes se standarteve te BE, per teknologjine e informacionit dhe komunikimit. |   |                           |  |  |  |                                      |                                |                       |
|  | Permiresimi i sistemeve te teknologjise se informacionit ne sistemin e drejtesise.                                 |   |                           | 65   |  |  | 50                                   |                                |                       |
| <b>Produktet</b>                                 |  |   |                           |  |  |  |                                      |                                |                       |
| <b>Kodi i treguesit</b>                          | <b>Emërtimi i treguesit</b>  |   |                           |  |  |  |                                      |                                |                       |
| 92903AA  | Akte të miratuara  |   | Numër aktesh të miratuara | 3  | 20   | 20   | 14                                   | 6                              | 70                    |
|  |  |   | lekë                      | 2,106,000                                  | 12,900,000                                     | 13,000,000                                       | 5,229,451                            | 7,770,549                      | 40                    |

|  |       |            |                          |       |             |
|--|-------|------------|--------------------------|-------|-------------|
| Drejtuesi i Ekspert Menaxhues të Programit | Emri  | Ervin Miso | Sekretari i Përgjithshëm | Emri  | Rudin Baqll |
|  | Firma |            |                          | Firma |             |
|  | Data  | 21.02.2024 |                          | Data  | 22.02.2024  |

ANEKSI nr.4 Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit

Periudha e Raportimit 12-2023

| Emri i Grupit  |  | Këshilli i Lartë Gjyqësor  |                      | Kodi i Grupit                              |   |   | 29                           |                         |                |
|--|--|--|----------------------|--|---|---|------------------------------|-------------------------|----------------|
| Emri i Programit   |  | Buxheti Gjyqësor   |                      | Kodi i Programit                           |   |   | 03310                        |                         |                |
| <b>Qëllimi i politikës së programit</b>  |  | Ofrimi efikas i shërbimeve dhe pune me e mire ne gjykatat e 3 niveleve |                      |  |   |   |                              |                         |                |
| <b>Treguesit e performancës në nivel qëllimi</b>   |  |  |                      | <b>Treguesit e performancës/Produktet:</b> |   |   |                              |                         |                |
| Kodi i treguesit   | Emërtimi i treguesit   | Tregues me bazë gjinore (PG)   | Njësia matese        | Fakti i Vitit Paraardhës                   | Buxheti Vjetor Plan Fillëstar Viti 2023 | Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023 | Fakti i Periudhës/progresive | Ndryshimi (Plan - Fakt) | % e realizimit |
|  | Rritja e nivelit të shërbimit të ofruar nëpërmjet një sistemi funksional, efikas, të mirëadministruar dhe që funksionon në shkallën më të lartë të integritetit.   |  |                      | 81   | 84                                      | 84  | 78                           | 6                       |                |
| <b>Objektivat e politikës së programit</b>   |  |  |                      |  |   |   |                              |                         |                |
| Te përmirësohet ofrimi i shërbimeve, përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjive, që zhvillojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale. |  |  |                      |  |   |   |                              |                         |                |
| <b>Objektivi</b>   | Përmirësimi, ose ngritja e sistemeve të teknologjive sa informacionit, të cilat përmbushin standardet ndërkombetare dhe rrisin efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, sipas rritjeve të ndryshimeve teknologjike. |  |                      | 96   | 78                                      | 78  | 78                           | 0                       |                |
|  | Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore (interfesa, mjedise pune), për të garantuar standarde bashkëkohore në përmbushje e detyrave kushtetuesdhe ofrimin dirijkoz të shërbimit për publikun.      |  |                      | 65   | 62                                      | 62  | 62                           | 0                       |                |
|  | Parqindja e magistratave femra kundrejt totalit të magistratave  | Po   |                      |  | 46                                      | 46  | 46                           | 0                       |                |
|  | Numri i grave në pozicione drejtuese ndaj totalit të posteve drejtuese   | Po   |                      |  |   |   | 61                           |                         |                |
| <b>Produktet</b>   |  |  |                      |  |   |   |                              |                         |                |
| Kodi i treguesit   | Emërtimi i treguesit   |  |                      |  |   |   |                              |                         |                |
| 9290244  | Çështje të gjykuara  |  | Numër çështjesh      | 259,983                                    | 143,180                                 | 143,180                                   | 119,802                      | 23,378                  | 84             |
|  |  |  | lekë                 | 2,659,586,841                              | 3,309,000,000                           | 4,109,645,564                             | 3,996,544,567                | 113,100,997             | 97             |
| 18AD801  | Mobilje dhe pajisje  |  | Numër institucioni   | 39   | 19                                      | 12  | 12                           | 0                       | 100            |
|  |  |  | lekë                 | 23,067,524                                 | 189,100,000                             | 15,700,000                                | 14,119,278                   | 1,580,722               | 90             |
| 18AD803  | Pajisje të tjera në funksion të aktivitetit të gjykatave   |  | Numër institucioni   |  |   |   |                              |                         | 0              |
|  |  |  | lekë                 | 0  | 0                                       | 0   | 0                            | 0                       | 0              |
| M290075  | Blerje mjeteve motorike  |  | Numër automjeteve    | 16   | 10                                      | 10  | 10                           | 0                       | 100            |
|  |  |  | lekë                 | 12,203,520                                 | 30,000,000                              | 26,300,000                                | 26,289,600                   | 10,400                  | 100            |
| M290066  | Projekt zbatimi për godina   |  | Numër projekteve     | 1  | 5                                       | 1   | 1                            | 0                       | 100            |
|  |  |  | lekë                 | 1,599,155                                  | 58,600,000                              | 600,000                                   | 300,000                      | 300,000                 | 50             |
| M290068  | Godina të rikonstruara   |  | Numër institucioni   | 4  | 20                                      | 8   | 6                            | 2                       | 75             |
|  |  |  | lekë                 | 63,592,050                                 | 56,500,000                              | 49,058,965                                | 34,426,413                   | 14,632,552              | 70             |
| 21AC401  | Blerje pajisje elektronike   |  | numër institucionesh | 37   | 33                                      | 20  | 20                           | 0                       | 100            |
|  |  |  | lekë                 | 19,247,240                                 | 20,000,000                              | 193,100,000                               | 186,991,200                  | 6,108,800               | 97             |
| 21ACS01  | Programë software për gjykatat   |  | numër programesh     | 3  | 10                                      | 4   | 4                            | 0                       | 100            |
|  |  |  | lekë                 | 203,184,820                                | 0                                       | 86,841,035                                | 76,981,681                   | 9,859,354               | 89             |

|  |       |                |                          |       |             |
|--|-------|----------------|--------------------------|-------|-------------|
| Drejtesi i Ekspit Menaxhues të Programit | Emri  | Çiljeta Prifti | Sekretari i Përgjithshëm | Emri  | Rudin Baqji |
|  | Firma |                |                          | Firma |             |
|  | Data  | 22.02.2024     |                          | Data  | 22.02.2024  |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR  
DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT

# Raporti i Monitorimit të Buxhetit

për  
vitin 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor

2023

2022

2021

2020

22 shkurt 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR  
DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT

RAPORTI

I

MONITORIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2023

Me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2023, janë miratuar në tre programe buxhetore:

- Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Programi buxhetor 01140, “**Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.
- Programi buxhetor 03310, “**Buxheti Gjyqësor**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Buxheti i miratuar me ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për të tre programet buxhetore në fillim të vitit ishte në shumën **4,362,600,000 lekë**, i ndarë përkatësisht:

- Programi 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, në shumën **324,700,000 lekë**.
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën **12,900,000 lekë**.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në shumën **4,025,000,000 lekë**.

Gjatë vitit 2023, buxheti i grupit buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është rishikuar si më poshtë:

1) Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” në shumën **4,500,000 lekë**. KLGJ me shkresën nr. 1359, datë 16.02.2023, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar detajimin e fondit të veçantë: Programi 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në shumën **1,200,000 lekë**. Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën **100,000 lekë**. Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor”, në shumën **3,200,000 lekë**. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023, ka miratuar këtë detajim.



- 2) Akordim fondi në zbatim të ligjit 33/2023, “Për një ndryshim në ligjin 96/2016’ “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës”, VKM nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”. KLGJ me shkresën nr. 3800, datë 05.07.2023 ka paraqitur pranë MFE – së, kërkesën për alokimin e një fondi shtesë në shumën **170,000,000 lekë** për mbulimin e efektit financiar në shpenzime personeli si rezultat i ndryshimeve ligjore të mësipërme. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar akordimin e fondit, me shkresën 12382/1, datë 18.07.2023.
- 3) Akordim fondi në zbatim të VKM nr. 437, datë 19.07.2023 “Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavaruara të krijuara me ligj”, në shumën **300,000,000 lekë**, akorduar nga MFE me shkresën nr 1656/1, datë 05.10.2023.
- 4) Akordim fondi, në zbatim të VKM nr. 755, datë 20.12.2023 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”, janë miratuar fonde shtesë në shpenzime korrente në grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, për vitin buxhetor 2023, në shumën **350,000,000 lekë**.
- 5) Pakësimin e fondit në shpenzime kapitale me Aktin Normativ nr 6, datë 14.12.2023 në shumën **344,400,000 lekë** i detajuar në disa projekte.
- 6) Akordim fondi nga MFE me shkresën nr. 22623/1, datë 03.01.2024, për pagesën pas ndërprerjes së funksionit për 3 ish anëtarët e KLGJ –së, në shumën **2,253,000 lekë** në artikullin 606, të programit 01110, për vitin buxhetor 2023.
- 7) Akordimi i fondit në zbatim të VKM nr. 834, datë 28.12.2023, “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave “ Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, në shumën **920,000 lekë** në artikullin 600 të programit 03310.
- 8) Akordim fondi në zbatim të VKM nr. 795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të ACQUIS (screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Europian”, në shumën **2,084,428 lekë**, nga të cilat; në programin 01110, në shumën 558,864 lekë dhe 1,525,564 lekë në programin 03310.

Gjatë vitit si rezultat i shtesave dhe pakësimeve, në zbatim të akteve ligjore të mësipërme, buxheti ka ndryshuar në vlerën absolute në total për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në shumën **485,357,428 lekë**, i cili është reflektuar edhe në ndryshimin e vlerës së fondeve buxhetore në nivel programi dhe artikulli sikurse do të shikojmë më poshtë.

Gjithashtu gjatë vitit brenda programeve buxhetore për plotësimin e nevojave në paga në shërbime apo investime, janë bërë disa rishpërndarje brenda të njëjtit program, të cilat kanë sjellë ndryshime në buxhetin e planifikuar në nivel artikulli apo projekti si më poshtë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën 12382/1, datë 18.07.2023 ka miratuar kërkesën e fondit shtesë në shumën **170,000,000 lekë**, i detajuar; 5,000,000 lekë në programin 01110 (4,000,000 lekë në paga dhe 1,000,000 lekë në sig. shoqërore) dhe 165,000,000 lekë në programin 03310 (140,000,000 lekë në paga dhe 25,000,000 lekë në sig. shoqërore).
- Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale, në zbatim të vendimit nr. 447, datë 24.07.2023, të KLGJ në shumën **173,100,000 lekë**, nga projekti 18AD801 “Blerje pajisje zyre” në projektin

21AC401 “Pajisje elektronike” në programin 03310 “Buxheti gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr.13654/1, datë 7.8.2023.

- Rishpërndarje fondi në shumën **18,000,000 lekë** nga artikulli 600” paga”, në artikullin 602 “mallra dhe shërbime të tjera”, të programit 03310 ”Buxheti gjyqësor “, mbështetur në vendimin e KLGJ nr. 640, datë 26.10.2023, miratuar nga MFE me shkresën 19645/1, data 01.11.2023, për përballimin e efektit financiar lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
- Rishpërndarja e fondit shtesë në shumën **350,000,000 lekë**, me vendimin e KLGJ nr. 741, datë 26.12.2023, përcjellë MFE-s me shkresën nr. 6520/1, datë 26.12.2023, nga të cilat në programim 01110 në shumën **20,000,000 lekë** në paga dhe në programin 03310 në shumën **330,000,000 lekë** (280,000,000 lekë në paga dhe 50,000,000 lekë në mallra dhe shërbime të tjera), Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 23938, datë 29.12.2023, ka miratuar rishpërndarjen.
- Rishpërndarja e fondeve në zbatim të vendimit nr. 7, të Bordit të QTI, datë 10.08.2023 në shumën **1,200,000 lekë** nga artikulli 600 “Paga”, në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, Ministria e Financave ka miratuar rishpërndarjen.
- Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale, në zbatim të vendimit nr. 495, datë 21.09.2023, të KLGJ në shumën **4,400,000 lekë** në programin 03310 “Buxhetit gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr 20492/1, datë 6.12.2023. U pakësua projekti M290066 ”Hartim projekti” dhe u shtua projekti M290068 “Rikonstruksion”.

Buxheti i rishikuar vjetor për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, pas ndryshimeve të mësipërme është në shumën **4,847,957,428 lekë**:

- Programi 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në shumën **353,711,864 lekë**, ndërsa realizimi për vitin 2023 është në shumën **320,480,546.17 lekë**, ose në masë **91%** e planit të rishikuar vjetor.

Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë” në shumën **13,000,000 lekë**. Realizimi për vitin 2023 është **5,229,451. lekë**, ose në masën **40%** e planit të rishikuar vjetor.

- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në shumën **4,481,245,564 lekë**. Realizimi për vitin 2023 është **4,338,582,196.93 lekë** ose në masën **97%** e planit të rishikuar vjetor.

Për vitin 2023 realizimi si grup buxhetor është në shumën **4,664,292,194 lekë** ose në masën **96%**, e buxhetit të rishikuar vjetor.

**Artikulli 600 (Paga)** – Në këtë artikull u programua në fillim të vitit për grupim buxhetor, fondi në shumën **2,619,550,000 lekë**. Si rezultat i ndryshimit të dispozitave ligjore të sipërcituar në paga dhe për mbulimin e efekteve financiare që rrjedhin prej tyre apo nevojave të lindura gjatë vitit, fondi në këtë artikull u rishikua në vlerë absolute në shumën **727,804,428 lekë** (**24,558,864 lekë** shtesë fondi në programin 01110, shtesë fondi në shumën **704.445.564 lekë** në programin 03310 dhe pakësimi fondi në shumën **1,200,000 lekë** në programin 01140). Buxheti i rishikuar vjetor në paga për grupin buxhetor është në shumën **3,347,354,428 lekë**, ndërsa realizimi për vitin 2023, është në shumën **3,285,262,563 lekë** ose në masën **98%** e buxhetit të rishikuar vjetor.

**Artikulli 601 (Sig Shoqërore)** – Në fillim të vitit në këtë artikull është programuar për programin buxhetor, fondi në shumën **319,150,000 lekë**. Si rezultat i ndryshimit të dispozitave ligjore si më sipër cituar, ky artikull u rishikua me një shtesë fondi për mbulimin e efektit financiar që derivon

nga ndryshimet e mësipërme ligjore në shumën **26,000,000 lekë (1,000,000 lekë** në programin 01110 dhe **25,000,000 lekë** në programin 03310). Buxheti i rishikuar në këtë artikull është **345,150,000 lekë**, ndërsa realizimi është **322,708,078 lekë**, ose në masën **94%** e planit të rishikuar vjetor.

Realizimi në këtë masë i fondeve në shpenzime personeli është i lidhur me vakancat e shumta në sistemin gjyqësor. Numri i punonjësve të Sistemit Gjyqësor i miratuar me ligj për vitin 2023, është 1,759 vetë, nga këto; 138 vetë janë punonjës të stafit të KLGJ-së, 6 vetë është numri i punonjësve të QTI-së, 1,615 vetë është organika e stafit gjyqësor. Numri faktik në fund të vitit 2023 për sistemin gjyqësor është 1,470 vetë, ndërsa mungesat janë 289 vetë (35+2+252=289) nga të cilat 35 janë vakancat në KLGJ, 2 janë në QTI, 252 janë vakancat në gjykata.

**Artikulli 602 (Mallra dhe shërbime të tjera)** – Në fillim të vitit, për grupin buxhetor u programua në këtë artikull fondi, në shumën **683,376,000 lekë**. Gjatë vitit si rezultat i rishikimit të fondit në vlerë absolute në shumën **69,200,000 lekë** (nga të cilat **68,000,000 lekë** në programin 03310 dhe **1,200,000 lekë** në programin 01140) fondi i rishikuar vjetor në këtë artikull është në shumën **752,576,000 lekë** dhe realizimi **697,534,691.63 lekë** ose në masën **93%**. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të këtij grupi buxhetor me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta. Janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, shpenzime postare, shpenzime transporti si dhe shpenzime të tjera si ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, pagesa për ekspertë, avokatë e psikolog, si dhe shpenzime mirëmbajtje (programi financiar, programi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore e sistemit audio video në gjykata) etj .

**Artikulli 606 (Trans. për Buxh. Fam. & Individ)** - Fondi i programuar në fillim të vitit në këtë artikull për grupin buxhetor ishte në shumën **9,524,000 lekë**. Fondi u programua për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, i ndryshuar, si dhe pagesat lidhur me përfitimin interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllime banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore.

Gjatë viti është rishikuar fondi në shumën **6,753,200 lekë**. Nga të cilat, akordimi i fondit të veçantë në shumën **4,500,000 lekë** dhe **2,253,000 lekë**, për pagesën pas ndërprerjes së funksionit për 3 ish anëtarët e KLGJ. Fondi për vitin 2023, është realizuar në shumën është **6,890,345.47 lekë** ose në masën **42%** e buxhetit të rishikuar vjetor.

Shpenzimet korrente në total për vitin 2023 për grupin buxhetor janë realizuar në masën **97%** e buxhetit të rishikuar vjetor, e cila tregon një përdorim të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efikasitet të lartë.

**Artikulli 230-231 (Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm)** - Fondi i programuar për shpenzime kapitale për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” në fillim të vitit ishte në shumën **731,000,000 lekë**. Gjatë vitit fondi është rishikuar në zbatim të Aktit Normativ nr. 6 datë 14.12.2023, duke u pakësuar (programi 03310) në shumën **344,400,000 lekë**, i detajuar sipas projekteve më poshtë:

- **artikulli 230 -M290066” Hartim Projekti “ në shumën 53,600,000 lekë.**

-**artikulli 231 në shumën 290,800,000 lekë sipas projekteve më poshtë;**

- 18AD801 “ Mobilje Pajisje” në shumën 300,000 lekë,
- 21AC501 “ Programe Software” në shumën 63,158,965 lekë,
- M290068 “ Rikonstruksion “ në shumën 11,841,035 lekë,
- M290074 “ Fondi i ngrirë” në shumën 211,800,000 lekë,
- M 290075 Blerje automjete” në shumën 3,700,000 lekë.

Ndërkohë gjatë vitit janë bërë edhe dy rishpërndarje fondi të cilat kanë ndryshuar vlerën e disa projekteve por jo buxhetin në tërësi.

- Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale në zbatim të vendimit nr. 447, datë 24.07.2023, të KLGj, në shumën 173,100,000 lekë nga projekti 18AD801 “Blerje pajisje zyre” në projektin 21AC401 “Pajisje elektronike” në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr.13654/1, datë 7.8.2023

- Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale në zbatim të vendimit nr. 495, datë 21.09.2023, të KLGj, në shumën 4,400,000 lekë në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr 20492/1, datë 6.12.2023. U pakësua projekti M290066 ”Hartim projekti” dhe u shtua projekti M290068 “Rikonstruksion”.

Buxheti i rishikuar vjetor në investime për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është në shumën 386,600,000 lekë, ndërsa realizimi vjetor është në shumën 351,896,516 lekë ose në masën 91%, nga të cilat;

- **Artikulli 230- (kapitale të patrupëzuara);** Fondi i rishikuar vjetor në këtë zë është në shumën 600,000 lekë. Fondi është realizuar në shumën 300,000 lekë ose në masën 50%. Masa e realizimit është e lidhur me tepicën e fondit gjatë prokurimit online.

- **Artikulli 231- (kapitale të trupëzuara);** Fondi i rishikuar vjetor në këtë zë është në shumën 386,000,000 lekë. Është realizur fondi në shumën 351,596,516 lekë ose në masën 91%.

Realizimi në këtë masë ka ardhur si rezultat i çeljes me vonesë nga MFE të fondit, e cila solli vonesë në procedurat e prokurimit. Fondi për “programe software” u çel i ngrirë dhe u ç’bllokua vetëm një pjesë e tij në muajin gusht.Gjatë vitit 2023 fondi i rishikuar sipas projekteve është realizuar, me përjashtim të fondit të detajuar në projektin “Rikonstruksion” të një gjykate që nuk u realizua pasi procedura u bllokua nga KPP dhe u ç’bllokua, në datën 26.12.2023, duke e bërë të pamundur realizimin e tij, ndërsa pjesa tjetër janë diferenca prokurimi online.

Përveç fondeve buxhetore, gjykatat në zbatim të VKM nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore” si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë të Drejtësisë nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore”, kanë përdorur edhe të ardhurat të krijuara prej tyre. Për vitin 2023, realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit (vetëm për programin 03310 - Buxheti Gjyqësor) është në shumën 20,421,652 lekë.(Aneksi 1, 1/1 dhe 1/2)

***Në mënyrë analitike performanca e buxhetit në nivel programi dhe kapitulli paraqitet si më poshtë (Aneksi 2, dhe 2/1):***

**I- Programi - 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”**

Buxheti i alokuar me ligjin e buxhetit, për Këshillin e Lartë Gjyqësor, në fillim të vitit 2023 ishte në shumën **324,700,000 lekë**, i detajuar përkatësisht në shumën **309,700,000 lekë** në shpenzime korrente dhe **15,000,000 lekë** në shpenzime kapitale të trupëzuara (artikulli 231).

Buxheti është rishikuar në këtë program si rezultat i alokimit të fondit të veçantë në shumën **1,200,000 lekë**, VKM 325, shtesë fondi në shumën **5,000,000 lekë** (4,000,000 lekë në paga dhe 1,000,000 lekë në sig. shoqërore, VKM nr.755, shtesë fondi në shumën **20,000,000 lekë** i nevojshëm për mbulimin e efektit financiar si rezultat i ndryshimit të dispozitave ligjore për sistemin e pagave, akordimi i fondit në shumën **2,253,000 lekë** në artikullin 606, me VKM nr. 795, shtesë fondi në shumën **558,864 lekë**. Në total buxheti në këtë program ka ndryshuar në vlerë absolute në shumën **29,011,864 lekë**, nga të cilat **24,558,864 lekë** në paga, **1,000,000 lekë** në sigurime shoqërore dhe **3,453,000 lekë** në artikullin 606.

Buxheti i rishikuar vjetor është në shumën **353,711,864 lekë**, nga të cilat **338,711,864 lekë** shpenzime korrente dhe **15,000,000 lekë** në investime.

Realizimi faktik për vitin është në shumën **320,480,546.17 lekë** ose në masën **91%** kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor, nga të cilat **307,692,202.17 lekë** në shpenzime korrente, ose në masën **91%** dhe **12,788,344 lekë** në shpenzime kapitale ose në masën **85%**.

“**Artikulli 600**” - Buxheti vjetor i programuar në “*Shpenzime paga*” për këtë program në fillim të vitit në shumën **209,000,000 lekë** u rishikua gjatë vitit me një shtesë fondi totale në shumën **24,558,864 lekë** i nevojshëm për të mbuluar efektin financiar si rezultat i ndryshimeve ligjore në paga. Buxheti i rishikuar vjetor në shumën **233,558,864 lekë** është realizuar në shumën **227,193,520 lekë** ose në masën **97%**.

“**Artikulli 601**”- Buxheti i programuar në shpenzime “*Sig. shoqërore dhe shëndetësore*” për këtë program në fillim të vitit në shumën **27,500,000 lekë**, u rishikua me një fond shtesë në shumën **1,000,000 lekë**. Buxheti i rishikuar vjetor në shumën **28,500,000 lekë** është realizuar në shumën **26,072,143 lekë** ose në masën **92%**.

Realizimi në këtë masë në shpenzime personeli është i lidhur me vakancat në strukturat e KLGJ. Numri i punonjësve të KLGJ-së i miratuar me ligj për vitin 2023, është **138** punonjës ndërsa aktualisht në fund të vitit në organikën faktike të KLGJ-së, rezultojnë **103** punonjës, pra ka një mungesë me **35** punonjës, që ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“**Artikulli 602**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program është në shumën **71,700,000 lekë**, ndërsa realizimi faktik është në shumën **51,618,229.17lekë** ose në masën**72%**, kundrejt planit të rishikuar vjetor. Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të KLGJ-së me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta si dhe janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve për drita, ujë, energji elektrike, postë etj. Ndërkohë për nevojat e stafit të KLGJ-së, ka përfunduar likuidimi i kontratave me objekt; "Shërbim printimi dhe fotokopjimi", "Shërbim larje automjetesh", "Shërbim mirëmbajtje automjetesh", “Pjesë këmbimi, goma, bateri për automjetet”, “Shërbim mirëmbajtje paisje audio - Sallë plenare", "Karburant” etj, në përputhje me kushtet kontraktuale.

“**Artikulli 606**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë*” për programin 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, për vitin 2023, është në shumën **1,500,000 lekë**. Fondi u programua kryesisht për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve

telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë” i ndryshuar. Fondit të detajuar në fillim të vitit në këtë artikull, sikurse cituam më sipër, ju shtua fondi i veçantë në shumën **1,200,000 lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023 si dhe fondi në shumën **2,253,000 lekë**, i cili u përdor për pagesën e 2 pagave të mbarimit të funksionit për tre ish anëtarët e KLGJ.

Buxheti i rishikuar në këtë artikull është në shumën **4,953,000 lekë**. Gjatë vitit është përdorur për nevojat e punonjësve të stafit të KLGJ-së, fondi në shumën **2,808,310 lekë**, ose në masën **57%** kundrejt planit të rishikuar vjetor.

Fondet në shpenzime korrente sipas buxhetit të rishikuar në shumën **338,711,864 lekë** janë realizuar në shumën **307,692,202.17 lekë** ose në masën **91%**. Realizimi në shpenzime korrente është i lidhur me produktin kryesor të këtij programi; **Produkti 92901AA** - “Vendime të miratuara”. (Në formatin 2 dhe 3 sistemi reflektohet gabimisht produkti i vjetër “Auditime të kryera”, kurse tek formati 4 është pasqyruar saktë)

“**Artikulli 231**” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program, është në shumën **15,000,000 lekë**, i detajuar në dy produkte:

- **Produkti M290072 “Blerje pajisje”** në shumën **14,500,000 lekë**, është programuar për plotësimin e nevojave të KLGJ-së me; “Pajisje audio vizuale; “Pajisje të tjera teknike”; “Pajisje kompjuterike”, “Pajisje të tjera zyre”. Fondi është realizuar në shumën **12,292,849 lekë**, ose në masën **85%**. Fondi i realizuar është përdorur për blerjen e pajisje audiovizive në shumën **10,167,249 lekë** dhe pajisje kompjuterike /elektronike në shumën **2,125,600 lekë**, për nevojat e stafit të KLGJ-së.

- **Produkti M290057 “Rikonstruksion”** janë programuar fondet në shumën **500,000 lekë**, të cilat janë përdorur për nevojat e identifikuar për rikonstruksion të ambienteve të godinës së KLGJ-së dhe përshtatjen e një zyre për Sektorin e Protokoll Arkivës. Fondi është realizuar në shumën **495,495 lekë**, ose në masën **99%**.

Në total fondi në shpenzime kapitale për këtë program në shumën **15,000,000 lekë** është realizuar në shumën **12,788,344 lekë** ose në masën **85%**.

## **II- Programi - 01140 “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”**

Fondi i mratuar me ligj në fillim të vitit për këtë program, si pjesë përbërëse e grupit buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, është në shumën **12,900,000 lekë**. Gjatë vitit 2023, buxheti është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **100,000 lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë program është në shumën **13,000,000 lekë**. Realizimi faktik për vitin 2023, është në shumën **5,229,451 lekë** ose në masën **40%** kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor.

“**Artikulli 600**” - Buxheti i programuar në “Paga”, për këtë program në fillim të vitit në shumën **10,850,000 lekë**, u rishikua gjatë vitit 2023. Me vendimin nr. 7, datë 10.08.2023, të Bordit të QTI dhe miratuar nga MFE, fondi në shumën 1,200,000 lekë, u transferua nga artikulli 600 “Paga” në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”. Buxheti i rishikuar vjetor në paga për këtë program është në shumën **9,650,000 lekë**, ndërsa realizimi është në shumën **3,665,628 lekë** ose në masën **38%**.

“**Artikulli 601**”- Buxheti i programuar në shpenzime “Sig. shoqërore dhe shëndetësore” për këtë program është në shumën **1,650,000 lekë**, realizimi faktik është në shumën **508,456 lekë** ose në masën **31%**.

Numri i punonjësve të QTI-së i miratuar me ligj për vitin 2023, është **6** punonjës, ndërsa aktualisht janë punësuar vetëm 4 punonjës (Drejtori i QTI-së dhe 3 specialistë), pra ka një mungesë me **2** punonjës, e cila ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“**Artikulli 602**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program në fillim të vitit në shumën **376,000 lekë**. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së këtij fondi për vijim normal të aktivitetit të këtij institucioni deri në përfundim të vitit buxhetor, KLGJ me shkresën nr 4602/1, datë 04.09.2023, ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesën për rishpërndarjen e fondit në shumën **1,200,000 lekë**, nga artikulli 600 (paga) në artikullin 602 (mallra dhe shërbime të tjera). Buxheti i rishikuar në shumën **1,576,000 lekë** është realizuar në shumën **1,055,367 lekë** ose në masën **67%**

“**Artikulli 606**” - Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*” në shumën **24,000 lekë**, do të përdorej kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare. Fondi është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **100,000 lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02. 2023. Gjatë vitit fondi në shumën **124,000 lekë** nuk është përdorur.

Fondet në këtë program janë të detajuara në shpenzime korrente dhe janë në funksion të produktit të vetëm të këtij programi që, është Produkti- 92903AA “Akte të miratuara”.

*Në formatin 2 dhe 3 të sistemit reflektohet gabimisht produkti i vjetër “programe dhe pajisje të STI” ndërsa në formatin 4 ai është pasqyruar saktë*

### **III - Programi - 03310 “Buxheti Gjyqësor”**

Fondi i programuar për këtë program në fillim të vitit 2023, në shumën **4,025,000,000 lekë**, u rishikua në zbatim të akteve ligjore dhe miratuar nga MFE si më poshtë;

- Akordimi i fondit të veçantë në shumën 3,200,000 lekë, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023.
- VKM nr. 325, 326, datë 31.05.2023, alokimi i fondit shtesë në shumën 165,000,000 lekë (140,000,000 lekë në paga dhe 25,000,000 lekë në sig.shoq.)
- Akordim fondi në paga në zbatim të VKM nr. 475, datë 26.10.2023 në shumën 300,000,000 lekë.
- Akordim fondi në zbatim të VKM nr.755, datë 20.12.2023 në shumën 330,000,000 lekë(280,000,000 në artikullin 600 dhe 50,000,000 lekë në artikullin 602)
- Akordim fondi në zbatim të VKM nr. 795,në shumën 1,525,564 lekë në paga.
- Akordim fondi në zbatim të VKM nr 834, në shumën 920,000 lekë në paga
- Pakësim fondi në zbatim të Aktit Normativ nr 6 datë 14.12.2023, në shumën 344,400,000 lekë në shpenzime kapitale.

Në total buxheti, si rezultat i shtesave dhe pakësimeve, në këtë program është rishikuar në shumën **456,245,564 lekë** nga të cilat; **shtesë** fondi në shumën 704,445,564 lekë në “paga”, në shumën 25,000,000 lekë në “sigurime shoqërore”, në shumën 68,000,000 lekë në “mallra dhe shërbime të

tjera”, në shumën 3,200,000 lekë “*transfera në buxhete familjare dhe individë*” dhe pakësimin të fondit në “*shpenzime kapitale*” në shumën 344,400,000 lekë (53,600,000 lekë në artikullin 230 dhe 290,800,000 lekë në art.231). Këto shtesa dhe pakësime janë reflektuar edhe në rishikimin e buxhetit në nivel artikulli si më poshtë.

Buxheti i rishikuar vjetor për këtë program është në shumën **4,481,245,564 lekë**; nga të cilat **4,109,645,564 lekë** në shpenzime korrekte dhe **371,600,000 lekë** në shpenzime kapitale.

Realizimi faktik është në shumën **4,338,582,196.93 lekë** ose në masën **97%**, nga të cilat **3,999,474,024.93 lekë** në shpenzime korrente ose në masën **97%** dhe **339,108,172 lekë** ose në masën **91%** në shpenzime kapitale.

Gjatë vitit 2023, gjykatat kanë realizuar shpenzime edhe nga të ardhurat e krijuara prej tyre. Në total janë kryer shpenzime nga të ardhurat në shumën **20,421,652 lekë**, nga të cilat në shumën **14,238,749 lekë** në mallra dhe shërbime (Art.602) dhe në shpenzime kapitale (Art 230+231) në shumën **6,182,903 lekë**; nga të cilat në shumën 94,558 lekë në shpenzime kapitale të patrupëzuara dhe 6,088,345 në shpenzime kapitale të trupëzuara.

Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“**Artikulli 600**” - Në “*Shpenzime paga*”, buxheti vjetor i alokuar për këtë program ishte në shumën **2,399,700,000 lekë**. Gjatë vitit fondi në këtë artikull ka ndryshuar në vlerën absolute në shumën 704,445,564 lekë. Këto ndryshime janë të lidhura me ndryshimet ligjore në paga dhe akteve ligjore të tjera që kanë dalë gjatë vitit sikurse u citua më sipër. Buxheti i rishikuar vjetor si rezultat i shtesës është në shumën **3,104,145,564 lekë**. Realizimi në këtë artikull për vitin 2023 është në shumën **3,054,403,415 lekë**, ose në masën **98%** e buxhetit të rishikuar vjetor.

“**Artikulli 601**”- Buxheti fillestar i programuar në shpenzime “*Sig. shoqërore dhe shëndetësore*” për këtë program ishte **290,000,000 lekë**. Buxheti i rishikuar si rezultat i shtesës së fondit në shumën **25,000,000 lekë** është **315,000,000 lekë**, ndërsa realizimi për vitin 2023, është në shumën **296,127,479. lekë** ose në masën **94%**.

Për vitin 2023, numri i miratuar me ligj për programin “Buxheti Gjyqësor”, është 1,615 punonjës nga këto: 408 janë magjistratë dhe 1,207 janë punonjës të administratës gjyqësore, ndërsa faktikisht në fund të vitit 2023 në strukturat organike të gjykatave rezultojnë 1,363 punonjës (329 magjistratë dhe 1,034 janë punonjës të administratës).

Aktualisht në gjykata ka mungesa në strukturën organike me 252 punonjës; nga të cilët 79 janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe 173 janë punonjës të administratës. Ndërkohë nga 329 magjistratë, që rezultojnë efektivisht në detyrë 51 prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75%.

“**Artikulli 602**” – Buxheti vjetor i alokuar për vitin 2023 në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” në fillim të vitit ishte në shumën **611,300,000 lekë**. Si rezultat i ndryshimeve të bëra gjatë vitit në shumën **68,000,000 lekë** ( 50,000,000 lekë akordim fondi dhe 18,000,000 lekë, rishpërndarje fondi nga artikulli 600, i programit 03310), Buxheti i rishikuar në shumën **679,300,000 lekë** është realizuar në shumën **644,861,095.46 lekë**, ose në masën **95%**. Gjykatat gjatë vitit, kanë shlyer detyrimet mujore për shërbime si energji elektrike, ujë, telefon, postë dhe



shërbimin korrier. Janë likuiduar shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, shpenzime për udhëtim e dieta, shpenzime për materiale e shërbime zyre, shpenzime të tjera speciale si ekzekutime vendime gjyqësore pagesa për ekspertë, avokatë, psikologë, etj. Pjesë e fondeve buxhetore të artikullit 602 “Shpenzime operative” janë dhe fondet e detajuara në programin 03310 të KLGJ –së në shumën **195,034,851 lekë**. Gjatë vitit 2023 është realizuar 100% objekti i prokurimit të fondit në shumën **187,491,402 lekë**, i cili është përdorur për likuidimin e kontratave vjetore me objekt; “Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes në gjykata”, në shumën **97,837,557 lekë**, “Shërbime mirëmbajtje të sistemit audio-video në gjykata RDA dhe Backup Chain”, në shumën **7,734,745 lekë**, “Shërbim interneti dhe intraneti për KLGJ-në dhe gjykatat”, në shumën **10,333,146 lekë**, “Shërbim mirëmbajtje e programit financiar”, në shumën **2,963,631 lekë**, “Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe infrastrukturës mbështetëse në gjykata”, në shumën **48,416,667 lekë**, “Liçensa, mirëmbajtje dhe zhvillim për programet M Files dhe SDM Lot”, në shumën **20,205,656 lekë**, likuidimi i të cilave është bërë gjatë vitit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë.

**“Artikulli 606”** - Buxheti vjetor i alokuar në *“Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”* i detajuar me ligjin e buxhetit në këtë program ishte në shumën **8,000,000 lekë**. Fondi u programua kryesisht për kryerjen e kompesimeve të shpenzimeve të telefonisë celulare, si dhe pagesat lidhur me përfitimin interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllime banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore.

Fondi i akorduar në këtë artikull u rishikua si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **3,200,000 lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë artikull në shumën **11,200,000 lekë**, është realizuar në shumën **4,082,035.47 lekë**, ose në masën **36%**.

*Përveç fondeve buxhetore, gjykatat kanë realizuar edhe shpenzime nga të ardhurat në funksion të aktivitetit të tyre në shumën 14,238,749 lekë.*

Realizimi i fondit në shpenzime korrente në masën **97%** janë të lidhur me realizimin e **Produktit nr. 1 - 92902AA “Çështje të gjykuara”**.

**“Artikulli 230+231”** Buxheti në shpenzime kapitale me financim të brendshëm për programin 03310, për vitin 2023, në shumën **716,000,000 lekë** u detajua në fillim të vitit, në Art. 230 *“Shpenzime kapitale të patrupëzuara”*, në shumën **58,600,000 lekë** dhe në Art. 231 *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”*, në shumën **657,400,000 lekë**.

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 fondi në investime është pakësuar në shumën totale 344,400,000 lekë, i detajuar sipas projekteve si më poshtë:

*Në artikullin 230 -M290066” Hartim Projekti “ në shumën 53,600,000 lekë,*

*Në artikullin 231 në shumën 290,800,000 lekë sipas projekteve më poshtë;*

*-18AD801 “ Mobilje Pajisje” në shumën 300,000 lekë,*

*- 21AC501 “ Programe Softëare” në shumën 63,158,965 lekë,*

*-M290068 “ Rikonstruksion “ në shumën 11,841,035 lekë,*

*- M290074 “ Fondi i ngrirë” në shumën 211,800,000 lekë,*

-M 290075 “Blerje automjete” në shumën 3,700,000 lekë.

Ndërkohë gjatë vitit janë bërë edhe dy rishpërndarje fondi, të cilat kanë ndryshuar vlerën e disa projekteve por jo buxhetin në tërësi.

▪ *Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale në zbatim të vendimit nr. 447, datë 24.07.2023, të KLGj në shumën 173,100,000 lekë, nga projekti 18AD801 “Blerje pajisje zyre” në projektin 21AC401 “Pajisje elektronike” në programin 03310 “Buxheti gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr.13654/1, datë 7.8.2023.*

▪ *Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale në zbatim të vendimit nr. 495, datë 21.09.2023, të KLGj në shumën 4,400,000 lekë në programin 03310 “Buxheti gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr 20492/1, datë 6.12.2023. U pakësua projekti M290066 “Hartim projekti” dhe u shtua projekti M290068 “Rikonstruksion”.*

Ndryshimet në fondin e investimeve gjatë vitit kanë sjellë për secilin projekt jo vetëm ndryshime vlerore por edhe sasiore.

Në total buxheti i rishikuar vjetor në investime për programin 03310 është në shumën **371,600,000 lekë** dhe është realizuar në shumën **339,108,172 lekë** ose në masën **91%** i detajuar si më poshtë:

“**Artikulli 230**” - Buxheti vjetor i rishikuar në “*Shpenzime kapitale të patrupëzuara*”, në shumën **600,000 lekë** është i detajuar vetëm për 1 produkt;

**Produkti - M290066 “Hartim projekti”** në shumën **600,000 lekë** u programua për projektin e rikonstruksionit të dhomës së serverit për Gj.Shk.I.J.P. Durrës. Fondi është realizuar në shumën **300,000 lekë**, ose në masën **50%**, kurse objekti i prokurimit është realizuar tërësisht.

“**Artikulli 231**” - Buxheti vjetor i rishikuar në “*Shpenzime kapitale të trupëzuara*”, për këtë program është në shumën **371,000,000 lekë**, ndërsa realizimi vjetor është **338,808,172 lekë** ose në masën **91%**. Fondi është i detajuar në 5 produkte si më poshtë:

**Produkti - M290068 - “Rikonstruksion”**, fondi rishikuar vjetor në shumën **49,058,965 lekë**, është planifikuar për nevojat e 8 gjykatave, ndërsa fondi është realizuar nga 6 gjykata në shumën **34,426,413 lekë**, ose në masën **70%**. Fondi i përealizuar i përket Gj.Sh.I.J.P.Durrës (13,200,000 lekë) dhe një fond (50,000 lekë) i mbajtur i pashpërndarë në programin 03310 të KLGJ.

**Produkti - 21AC501- “Programe Software për gjykatat”**; Fondi i rishikuar vjetor në këtë projekt është në shumën **86,841,035 lekë** i planifikuar për 4 projekte. Është realizuar fondi në shumën **76,981,681 lekë**, ose në masën **89%** e fondit për shlyerjen e 4 projekteve; Pajisje & Program Disaster në shumën **1,903,670 lekë**; Pajisje & Program Digitalizimi i arkivave të gjykatave në shumën **37,758,011 lekë**, Pajisje & Program Menaxhimi i çështjeve gjyqësore në gjykata në shumën **30,360,000 lekë** dhe Pajisje & Program Implementimi i regjistrit elektronik OJF në shumën **6,960,000 lekë**.

**Produkti - 18AD801 “Blerje orendi e pajisje zyre”**; Fondi i rishikuar vjetor në këtë projekt është në shumën **15,700,000 lekë** i detajuar për 12 gjykata. Gjatë vitit 2023, fondi është realizuar nga të gjitha gjykatat në shumën **14,119,278 lekë**, ose në masën **90%**.

**Produkti - 21AC401 “Blerje pajisje elektronike”**, Buxheti i rishikuar vjetor është në shumën **193,100,000 lekë** (shitesë fondi në shumën 173,100,000 lekë, transferuar nga produkti 18AD801, sipas kërkesës së KLGJ-së nr. 4299, datë 24.07.2023 dhe miratuar nga MFE me shkresën 13654/1, datë 07.08.2023) i detajuar në programin 03310 të KLGJ-së. Fondi ka shërbyer për plotësimin e

nevojave të gjykatave me infrastrukturën elektronike si server, switch, kompjuter, UPS serveri, UPS kompjuteri, printer, sisteme fonie, skaner, fotokopje, diktofon, harddisk, monitor si dhe për realizimin e projektit për regjistrimin video të sallave të gjyqit RDA, për 20 gjykatat e të gjitha niveleve. Buxheti është realizuar në shumën **186,991,200 lekë**, ose në masën **97%**.

**Produkti - M290075 “Blerje mjete motorike”**- Buxheti i rishikuar vjetor është në shumën **26,300,000 lekë**, i detajuar në programin 03310 të KLGJ-së, për blerjen e 10 automjeteve. Fondi është realizuar në shumën **26,289,600 lekë** ose në masën 100%. Fondi është përdorur për blerjen e 10 copë automjeteve, për përmirësimin dhe rinovimin e mjeteve të transportit në sistemin gjyqësor.

Fondi i planifikuar në shpenzime kapitale (**Art 230+231**), në këtë program, në shumën **371,600,000 lekë**, është realizuar në shumën **339,108,172 lekë**, ose në masën **91%**.

Përveç fondeve buxhetore janë realizuar edhe shpenzime nga të ardhurat si më poshtë ;

Në shpenzime kapitale të patrupëzuara, artikulli 230:

- *M290066 “Hartim Projekti” në shumën 94,558 lekë për realizimin e hartimit të projektit për dy gjykata.*

Në shpenzime kapitale të trupëzuara, artikullin 231 janë realizuar nga të ardhurat shpenzime në shumën 6,088,345 lekë sipas projekteve të mëposhtme;

- *M290068 “Rikonstruksion” në shumën 955,237 lekë, për realizimin e punimeve të mirëmbajtjes në 5 gjykata.*
- *18AD801 “Blerje pajisje zyre” në shumën 3,201,226 lekë, nga 11 gjykata.*
- *21AC401 “Pajisje elektronike” në shumën 1,931,882 lekë, nga 3 gjykata.*

**Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve deviacioni i kostos për njësi dhe realizimit të treguesve të performancës së programit ( Aneksi 3, 3/1, 3/2 dhe 4).**

### **I - Programi - 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”**

Qëllimi kryesor për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” është “Përmirësimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve financiare të nevojshme”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar objektivi: “KLGJ-ja do të angazhohet në vendosjen e standardeve të larta të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të saj si dhe për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të tre nivelet” me tregues performance:

1. *Numri i akteve nënligjore të miratuara nga KLGJ-ja në masën 95%.*

Gjatë viti 2023 janë marrë nga KLGJ, 743 vendime dhe 27 prej tyre ose në masën **3.6%** janë akte nënligjore.

2. *Përqindja e grave në poste drejtuese ndaj totalit të posteve drejtuese në KLGJ në masën 43%.*

Gjatë vitit 2023 ky tregues është realizuar plotësisht. Deri në fund të viti 2023, në KLGJ, në pozicione drejtuese rezultojnë 23 femra nga 54 pozicione drejtuese ose **43%** e totalit të pozicioneve drejtuese.

### 3. Numri i vlerësimeve etiko-profesionale të magjistratëve në masën 69%.

Për periudhën 1 vjeçare të raportimit për procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, të filluara gjatë vitit 2023 dhe të mbartura nga viti paraardhës (gradim, vlerësime të përsheptuara të detyruara dhe vlerësime 3-vjeçare), rezulton të kenë përfunduar me miratim të raportit të vlerësimit 46% e vlerësimeve të filluara.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 3 produktet e mëposhtme:

- **Produkti 92901AA** - “Vendime të miratuara” - Njësia matëse - “Numër vendimesh.”

Në fillim të vitit mbështetur në politikën e programit, objektivin dhe stafin, u planifikuan rreth 600 vendime. Gjatë vitit 2023, janë realizuar 743 të tilla ose në masën **124%**. Fondet në shpenzime korrente sipas buxhetit të rishikuar për realizimin e këtij produkti janë realizuar në masën **91%**. Për realizimin e këtyre vendimeve janë shpenzuar **307,692,202.17 lekë** (që i referohen shumës së shpenzimeve korrente të realizuara) kundrejt **338,711,864 lekë** të planifikuara. Kostoja faktike për vendim është **414,121 lekë/vendim**, kundrejt **564,520 lekë** sipas buxhetit të rishikuar ose **27%** më e ulët. Deviacioni i koston faktike për njësi gjatë viteve është i lidhur me ndryshimet në fondin e pagave dhe mos plotësimi i strukturës së KLGJ-së.

- **Produkti M290072**- “Pajisje elektronike ” (Blerje pajisje) - Njësia matëse – Numër institucioni.

Ky produkt është programuar për nevojat e KLGJ-së (1 institucion) dhe është realizuar nga 1 i tillë ose në masën **100%**, ndërsa realizimi vleror është **85%**. Për realizimin e këtij produkti janë shpenzuar mesatarisht 12,292,849 lekë, kundrejt 14,500,000 lekë të planifikuara. Kostoja faktike për njësi është ulur në masën **15%**, kundrejt koston së planifikuar.

- **Produkti M290057** - Rikonstruksion - Njësia matëse – Numër institucioni.

Ky produkt është programuar për 1 institucion (KLGJ) dhe është realizuar tërësisht në terma sasior në masën **100%**, ndërsa në terma vleror në masën **99%**. Kostoja faktike për njësi është **495,495 lekë** nga **500,000 lekë** të programuara në fillim të vitit ose 1% më e ulët. Deviacioni në kosto është i lidhur me diferencat e krijuara nga prokurimi online.

*Deviacioni i koston për njësi ka ardhur si rezultat i rishikimit të buxhetit në këtë program.*

## **II- Programin 01140 “Mbështetje për teknologjinë, e sistemit të drejtësisë”**

Programi buxhetor “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” ka për qëllim: “Përcaktimi i prioriteteve, politikave dhe standarteve, në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektiv “Angazhimi i QTI-së, për garantimin e arritjes së standardeve të BE-së, për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit” me tregues performance:

Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë në masën 50%.

Për realizimin e këtij treguesi është planifikuar 1 produkt për këtë program:

Produkti 92903AA - “Akte të miratuara”.

Fondet e programura në këtë program janë të detajuara tërësisht në shpenzime korrente dhe janë të lidhura me realizimin e këtij produkti. Për vitin 2023 janë planifikuar të miratohen 20 akte. Gjatë

vitit janë miratuar 14 akte, ose 70% e numrit të planifikur. Për realizimin e këtyre 14 akteve janë shpenzuar 5,229,451 lekë, nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose në masën 40%. Kostoja faktike për njësi është **373,532 lekë/akt**, kundrejt **650,000 lekë/akt** sipas buxhetit të rishikuar vjetor, ose **42%** më e ulët. Deviacioni i kostos faktike për njësi, kundrejt planifikimit fillestar dhe atij të rishikuar është i lidhur me realizimin e fondit në masën **40%** si dhe realizimit në masën **70%** e numrit të akteve.

### **III - Programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”**

Qëllimi kryesor për programin “Buxheti Gjyqësor” është: “Ofrimi efikas i shërbimeve dhe punë më e mirë në gjykatat e 3 niveleve”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektiv; *“Të përmirësohet ofrimi i shërbimeve përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë, që zhvillojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale”*, me tregues performance:

1. *Përqindja e grave në poste drejtuese ndaj totalit të posteve drejtuese në masën 61%*

Treguesi është realizuar plotësisht në masën 61% pasi nga 176 poste drejtuese (poste drejtuese të nivelit të lartë të mesëm dhe të ulët) në sistemin gjyqësor, 107 prej tyre janë femra ose në masën 61%. Treguesi është i lidhur me produktin nr.1.

2. *Përqindja e magjistrateve femra kundrejt totalit të magjistratëve në masën 46%*

Treguesi është realizuar plotësisht. Nga 408 magjistratë të miratuar me ligj, 187 prej tyre janë femra ose në masën 46%. Treguesi është i lidhur me produktin nr.1.

3. *Përmirësimi, ose ngritja e sistemeve të teknologjisë së informacionit, të cilat përmbushin standardet ndërkombëtare dhe rrisin efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, sipas ritmeve të ndryshimeve të teknologjisë, në masën 78%.*

Treguesi është i lidhur me produktin nr. 6 dhe 7 të cilët gjatë viti janë realizuar 100%. (mbështetur në raportin fakt/plan për njësi).

4. *Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore (ndërtesa, mjedise pune), për të garantuar standarde bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ofrimin dinjitoz të shërbimit për publikun, në masën 62%.*

Realizimi i këtij treguesi është i lidhur me realizimin në terma sasiorë të 4 produkteve (nr. 2,3,4,5) të tjera të planifikuara në këtë program. Gjatë vitit 2023 ky tregues është realizuar në masën 93.8%. Përqindja e realizimit të treguesit i referohet vlerës mesatare të përqindjes së realizimit të treguesve të 4 produkteve që lidhen me realizimin e tij.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 7 produktet e mëposhtme:

- 1- Produkti: 92902AA - “Çështje të gjykuara”
- 2- Produkti: 18AD801 - “Mobilje dhe pajisje”
- 3- Produkti: M290075 - “Blerje mjete motorrike”
- 4- Produkti M290066 - “Hartim Projekti”
- 5- Produkti: M290068 - “Rikonstruksion”
- 6- Produkti: 21AC401 - “Blerje pajisje elektronike”
- 7- Produkti: 21AC501 - “Programe software për gjykatat”

Gjatë vitit 2023, performaca e realizimit të produkteve mbështetur në njësinë matëse të produktit, kostoja për njësi për secilin produkt dhe deviacioni i saj gjatë vitit si rezultat i ndryshimeve buxhetore apo sasiore, paraqitet si më poshtë:

1- **Produkti: 92902AA “Çështje të gjykuara”**- Njësia matëse - Numër çështjesh.

Parashikimi i numrit të çështjeve nga ana e gjykatave është kryer referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite si edhe në përputhje me situatën specifike në Sistemin Gjyqësor gjatë vitit 2023, ku në zbatim të VKM nr.495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” është bërë riorganizimi i gjykatave të tre niveleve. Gjithashtu për shkak të mungesave në strukturat organike të gjykatave, është rritur ngarkesa e gjyqtarëve me gjykime, të cilat kanë çuar në zgjatjen e afatit të gjykimit.

Numri i çështjeve të parashikuara për vitin 2023, ishte **143,180** çështje. Sipas raportimit nga gjykatat, gjatë vitit 2023 janë realizuar **119,802** çështje, ose **84 %** e numrit të planifikuar. Ndërsa realizimi vleror i tyre që lidhet me realizimin e shpenzimeve korrente është në masën 97%. Për realizimin e 119,802 çështjeve janë shpenzuar **3,999,474,025 lekë**, kundrejt **4,109,645,564 lekë** sipas buxhetit të rishikuar vjetor. Kostoja faktike për njësi është **33,384.5lekë /çështje**, kundrejt **23,111 lekë/çështje** të programuar në fillim të viti, ose kostoja është më e lartë në masën 16%. Deviacioni i koston në këtë produkt është e lidhur me rishikimin e buxhetit në shpenzime korrente dhe përqindjen e realizimit të numrit të çështjeve në masën 84%.

2- **Produkti:18AD801“Mobilje dhe pajisje”** -Njësia matëse – Numër institucioni.

Për vitin 2023 u programua fondi për mobilje dhe pajisje për zyra dhe salla gjyqi pajisje sigurie dhe pajisje të tjera për 19 gjykata, në shumën 189,100,000 lekë. Fondi i pakësuar në shumën 173,400,000 lekë në këtë produkt ka sjellë edhe rishikimin e numrit të tyre nga 19 gjykata në 12 të tilla. Nga 12 gjykata të planifikuara sipas buxhetit të rishikuar vjetor produkti është realizuar në 12 të tilla ose në masën **100%**. Fondi për realizimin e tyre është realizuar në masën **90 %**. Kostoja faktike për njësi është në shumën **1,176,606.5 lekë /institucion**, kundrejt **1,308,333 lekë /institucion**, sipas koston me buxhetin e planifikuar, ose më e ulët në masën **10%**. Deviacioni në kosto ka ardhur si rezultat i rishikimit të buxhetit në terma vlerorë dhe sasiore. Produkti është realizuar në masën **100%** .

3- **Produkti:M290075 “Blerje mjete motorike”** -Njësia matëse – Numër mjetesesh.

Buxheti i programuar në shumën 30,000,000 lekë u rishikua në shumën 26,300,000 lekë fondi (pakësuar me A.N nr. 6, datë 14.12.2023 në shumën 3,700,000 lekë), është realizuar në shumën 26,289,600 lekë për blerjen e 10 automjeteve, sikurse ishte planifikuar. Për vitin 2023, kostoja mesatare për 1 automjet për këtë produkt është **2,628,960 lekë/mjet**, kundrejt **2,630,000 lekë/mjet**, të planifikuar. Fondi është realizuar në terma **sasior** dhe **vleror** në masën **100%**. Deviacioni në kosto është e lidhur me ndryshimet e fondit dhe kursimet gjatë prokurimit online. Produkti është realizuar në masën 100%

4- **Produkti M290066 “ Projekt zbatimimi për godina”** - Njësia matëse - Numër Projektesh

Për vitin 2023, fondi në këtë produkt u programua fondi për realizimin e hartim projektit për godinat e reja të 4 gjykatave dhe realizimin e dhomës së serverit të një gjykate. Gjatë vitit 2023, produkti është rishikuar në vlerën dhe në sasi si rezultat i pakësimit të fondit me A.Normativ nr. 6, datë 14.12.2023. Fondi i rishikuar vjetor është **600,000 lekë** për **1 projekt** (hartim projekti për

dhomën e serverit për Gj.Sh.P.J.P.Durrës). Produkti në terma sasior është realizuar plotësisht në masën **100%**, ndërsa në terma vleror është realizuar në masën **50%**. Kostoja faktike për njësi është **300,000 lekë/projekt**, nga **600,000 lekë/projekt** sipas buxhetit të rishikuar, ose **50%** më e ulët. Ndryshimi i kostos faktike, kundrejt planit fillestar dhe të rishikuar është i lidhur me ndryshimet buxhetore si dhe teprica e fondit gjatë prokurimit online. Produkti është realizuar në masën 100%

5- **Produkti: M290068 “Rikonstruksion”** - Njësia matëse – Numër institucioni.

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë produkt në shumën **49,058,965 lekë** i planifikuar për 8 gjykata është realizuar nga 6 të tilla, në shumën **34,426,413 lekë**. Për vitin 2023 produkti është realizuar në masën **75%** ndërsa fondi për këtë produkt është realizuar në masën **70%**. Kostoja faktike për njësi është në shumën **5,737,735.5 lekë/institucion**, kundrejt **6,132,371lekë/institucion** të planifikuara ose më të ulta në masën **6%**. Deviacioni në kosto ka ardhur si rezultat i rishikimit të buxhetit në terma vlerorë dhe sasiorë, dhe mos realizimi i fondit të detajuar nga 2 institucione.

6- **Produkti: 21AC401 –“Blerje Pajisje Elektronike ”** - Njësia matëse - Numër institucioni.

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë produkt në shumën **193,100,000 lekë**, është realizuar në shumën **186,991,200 lekë**, për plotësimin e nevojave të 20 gjykatave të planifikuara me kompjutera e pajisje të ndryshme elektronike. Produkti në terma sasior është realizuar 100%. Ndërsa fondi për produktin është realizuar në masën **97%**. Për vitin 2023 për plotësimin e nevojave të gjykatave me pajisje elektronike janë shpenzuar mesatarisht **9,349,560 lekë/gjykatë**, kundrejt **9,655,000 lekë/gjykatë** sipas buxhetit të rishikuar, ose kostoja për njësi gjatë vitit është ulur me 3%. Deviacioni në kosto ka ardhur si rezultat i rishikimit të buxhetit në terma vlerorë dhe sasiorë dhe tepricave të krijuara gjatë prokurimit online. Produkti është realizuar në masën **100%**

7- **Produkti: 21AC501 “Programe Software”**- Njësia matëse –Numër programesh.

Buxheti i rishikuar vjetor u planifikua për realizimin e 4 projekteve dhe janë realizuar 4 prej tyre ose në masën 100%. Fondi për realizimin e tyre është realizuar në masën 89%, kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor. Kostoja faktike për njësi për këtë produkt për vitin 2023, është **19,245,420 lekë/program**, kundrejt **21,710,259 lekë/program**, ose **11%** më e ulët. Produkti është realizuar në masën **100%**

Deviacioni i kostos për njësi të produkteve në këtë program ka ardhur si rezultat i rishikimit të buxhetit në terma vleror dhe sasior. Viti 2023 ka qënë një vit buxhetor specifik i cili ka patur ndryshime të shumta ligjore në paga si për magjistratët (me një efekt financiar aspak të vogël) edhe për punonjësit e tjerë të administratës gjyqësore, të cilat janë reflektuar me ndryshimin në buxhetin e sistemit gjyqësor dhe në koston e produkteve të planifikuara. Gjithashtu vakancat në strukturat organike të gjykatave, kanë sjellë realizimin e numrit të çështjeve në masën 84%, që ka ndikuar në koston e produktit kryesor, që zë edhe pjesën më të madhe të buxhetit gjyqësor.

### Projekte kapitale

Detajimi i fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2023, në shpenzime kapitale (investime) sipas grupeve të investimeve dhe kodit të projektit, u krye duke mbajtur në vëmendje; nevojat e shpenzimeve për programe software si dhe nevojat e përvitshme për pajisje elektronike (të cilat garantojnë funksionimin normal dhe mënjanojnë riskun e ndërprerjes së funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore), nevojat për pajisje zyre, kryesisht zëvendësimin e atyre të amortizuara dhe nevojat shtesë të lindura, plotësimin e nevojave për pajisje sigurie, plotësimin e

nevojave për rikonstrukcionet e pjesshme sipas kërkesave të gjykatave. Fondi i akorduar për vitin 2023 në shpenzime kapitale, për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” në fillim të vitit ishte në shumën **731,000,000 lekë**. Nga të cilat në shumën **15,000,000 lekë**, në programin 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” dhe në shumën **716,000,000 lekë** në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”.

Me Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 fondi në programin 03310 u pakësua në shumën 344,400,000 lekë.

Në total buxheti i rishikuar vjetor në investime për programin 03310 është në shumën **371,600,000 lekë** ndërsa për të dy programet buxheti i rishikuar vjetor në shpenzime kapitale është në shumën **386,600,000 lekë** dhe është realizuar në shumën **351,896,516 lekë** ose në masën **91%** i detajuar sipas programeve si më poshtë:

### **I - Programi - 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”**

Për programin 01110- “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” për vitin 2023 janë programuar të realizohen 2 projekte në shumën totale **15,000,000 lekë**, të detajuar si më poshtë:

**1- Projekti M290057 “Rikonstrukcion”;** fondet janë detajuar në shumën **500,000 lekë**, të cilat janë parashikuar të përdoren për nevojat e identifikuar për rikonstrukcion të ambienteve të godinës së KLGJ dhe përshtatjen e një zyre për Sektorin e Protokoll Arkivës. Fondi është realizuar plotësisht në vlerën **495,495 lekë**, ose në masën 99%

**2- Projekti M290072 Blerje Pajisje (Pajisje elektronike);** fondet janë detajuar në shumën **14,500,000 lekë**, të cilat u përdorën;

Në “Pajisje audio vizuale”, kryesisht për nevojat e identifikuar dhe të programuara nga Sektori IT, në kuadër të implementimit të hartës së re gjyqësore, për blerje pajisje për sistemin e qendëruar në KLGJ për videokonferenca në gjykata. Këto pajisje përmirësojnë aksesin në drejtësi, duke ofruar mjete e pajisje të një cilësie të lartë të TI-së, për komunikim e video konferenca në gjykata. Në “Pajisje të tjera teknike” kryesisht për blerje pajisje për sallë trajnimesh dhe përkthimi simultant, ku përfshihen monitorë interaktiv, mikrofonta, kabinë përkthimi, etj.

- Në “Pajisje të tjera zyre”, kryesisht për nevojat e kërkesat e identifikuar nga Sektori i Shërbimeve Administrative, për blerje pajisje të ndryshme zyre.

- Në “Pajisje kompjuterike”, kryesisht për blerje pajisje kompjuterike, si dhe SAN SËITCH, i cili do lidhë serverat me storage, Kompjuter Desktop 1, etj. Gjithashtu, për blerje aksesore Sëitch Layer 2, i cili kombinon funksionalitetin e një sëitch-i dhe një ruteri, që do të shërbejnë si ndërlidhës për pajisjet që janë në të njëjtin rrjet ose LAN virtual, me një shpejtësi shumë të lartë dhe ka inteligjencë të integruar. Gjatë vitit 2023 janë realizuar për këtë qëllim **12,292,849 lekë** ose në masën **85%**.

Në total fondi në shpenzime kapitale për këtë program në shumën **15,000,000 lekë**, është realizuar në shumën **12,788,344 lekë**, ose në masën **85%**. Realizimi në këtë masë është e lidhur me tepricat nga prokurimi online, pasi objektet e prokurimit janë realizuar plotësisht.

### **II - Programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”**



Për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” në fillim të vitit 2023, janë programuar të realizohen 6 projekte, në shumën totale 716,000,000 lekë.

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023 fondi në investime është pakësuar në shumën totale 344,400,000 lekë, pakësim që i përket disa projekteve si më poshtë:

***në artikullin 230***

*-M290066” Hartim Projekti “ në shumën 53,600,000 lekë,*

***në artikullin 231 në shumën 290,800,000 lekë sipas projekteve më poshtë;***

*-18AD801 “ Mobilje Pajisje” në shumën 300,000 lekë,*

*- 21AC501 “ Programe Softëare” në shumën 63,158,965 lekë,*

*-M290068 “ Rikonstruksion “ në shumën 11,841,035 lekë,*

*- M290074 “ Fondi i ngrirë” në shumën 211,800,000 lekë,*

*-M 290075 Blerje automjete” në shumën 3,700,000 lekë.*

Ndërkohë gjatë vitit janë bërë edhe dy rishpërndarje fondi të cilat kanë ndryshuar vlerën e disa projekteve por jo buxhetin në tërësi.

- *Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale në zbatim të vendimit nr. 447, datë 24.07.2023, të KLGj në shumën 173,100,000 lekë nga projekti 18AD801 “Blerje pajisje zyre” në projektin 21AC401 “Pajisje elektronike” në programin 03310 “Buxheti gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr.13654/1, datë 7.8.2023*
- *Rishpërndarje e fondit në shpenzime kapitale në zbatim të vendimit nr. 495, datë 21.09.2023, të KLGj në shumën 4,400,000 lekë në programin 03310 “Buxheti gjyqësor”, miratuar nga MFE me shkresën nr 20492/1, datë 6.12.2023. U pakësua projekti M290066”Hartim projekti” dhe u shtua projekti M290068 “Rikonstruksion”.*

**1- Projekti M290066 “Studime dhe Projektme”(Hartim Projekti):** Fondi i rishikuar vjetor në shumën 600,000 lekë i programuar për Gj.Sh.P.J.P.Durrës, për hartim projekti për dhomën e serverit të kësaj gjykate. Gjykata ka përfunduar realizimin e hartimit të projektit sipas planifikimit në shumën **300,000 lekë**.

**2-Projektit 21AC501 “Programe Software për gjykatat”,** janë detajuar fonde për vitin 2023 në shumën 361,800 lekë të parashikuara të përdoren për disa projekte të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, në sistemin gjyqësor. Fondi është çelur i ngrirë dhe ç’bllokimi i tij pjesor, në shumën 150,000,000 lekë është bërë nga MFE me shkresën nr 8091/2, datë 16.08.2023. Në këto kushte, fondi i çelur u përdor për realizimin e 4 projekteve të cilat ishin vazhdim nga viti 2022. Ndërsa 6 projektet e reja të filluara në vitin 2023 nuk u realizuan për shkak të ngrirjes së fondit dhe rishikimit të tij më aktin normativ Nr. 6, datë 14.12.2023;

*-Projekti për zhvillimin i një aplikacioni web për regjistrin elektronik të urdhërit mbrojtjes. **Fondi nuk është realizuar.***

*-Projekti aplikacioni për avokatët, i dizenuar të përdoret për sisteme operimi i OS, Android për Smart Phone. **Fondi nuk është realizuar.***

*-Projekti e-inspektori, për t'i mundësuar akses Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Fondi nuk është realizuar.*

*-Projekti i nënshkrimit elektronik dhe të pagesave online. Fondi nuk është realizuar.*

*- Projekti Infrastruktura mbështetëse për hostimin e sistemit të ri ICMIS. Fondi nuk është realizuar.*

*- Projektit për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Fondi nuk është realizuar.*

*- Projekti për digjitalizimin e dosjeve të arkivit gjyqësor, për vitin 2023 është realizuar fondi në shumën **37,758,011 lekë**. Ky projekt ka filluar të implementohet gjatë vitit 2022. Realizimi i tij do të mundësojë skanimin e të gjithë dokumentacionit, me skaner profesional dhe indeksimi i këtij informacioni të skanuar në një sistem arkive për menaxhimin dhe aksesimin e dokumentave në mënyrë të sigurt dhe të shpejtë.*

*-Blerje pajisje software, instalim dhe zhvillime të reja në sistemin ICMIS, Vlera e plotë e projektit është në shumën 51,500,000 lekë. Ky projekt ka filluar të implementohet gjatë vitit 2022. Gjatë viti 2023 është realizuar fondi në shumën **30,360,000 lekë**.*

*- Projekti Disaster recovery, Vlera e plotë e projektit është në shumën 36,000,000 lekë. Ky projekt ka filluar të implementohet gjatë vitit 2022. Realizuar gjatë vitit 2023 fondi në shumën **1,903,670 lekë**.*

*- Projekti Regjistri elektronik kombëtar OJF. Vlera e plotë e projektit është në shumën 57,000,000 lekë. Ky projekt ka filluar të implementohet gjatë vitit 2022. Për vitin 2023 është realizuar fondi në shumën **6,960,000lekë***

Nw total **projekti 21AC501** në shumën 86,841,035 lekë është realizuar në shumën **76,981,681 lekë** ose **89%** e fondit.

2- **Projekti M290068** “Rikonstrukcion” Fondi i rishikuar vjetor në këtë projekt si rezultati ndryshimeve në zbatim të akteve ligjore është **49,058,965 lekë**, ndërsa realizimi është **34,426,413 lekë** ose në masën **89%** nga 6 gjykata. Realizimi në këtë masë është i lidhur me mos realizimin e fondit nga Gj.SH.I.J.P. Durrës dhe fondi i mbajtur i pashpërndarë në programin 03310, të KLGJ-së, në total në shumën 13,250,000 lekë.

Fondi i detajuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në shumën 13,200,000 lekë, nuk është realizuar, pasi gjatë procesit të prokurimit si rezultat i ankimit nga një operator, procedura u bllokua nga KPP. Pasi u ankimua, procedura u çbllokua në datën 26.12.2023, duke bërë të pamundur realizimin e këtij fondi.

Fondi në shumën 50,000 lekë i detajuar në programin 03310, të KLGJ-së, i programuar të përdoret për riparime apo rregullime të pjesshme të godinave, për nevojat që mund të lindnin gjatë procesit të implementimit të hartës së re gjyqësore nuk është realizuar.

Ndërsa fondi i realizuar në total, në këtë projekt, në shumën **34,426,413 lekë**, i përket gjykatave të mëposhtme;

- 1) Fondi i detajuar për Gjykatën e Lartë në shumën 10,900,000 lekë, është realizuar plotësisht në shumën 9,905,236 lekë. Fondi u përdor për rikonstruksionin në nivel mirëmbajtje të godinës së kësaj gjykate, ose në masën 91%. Diferenca e mbetur është tepërcë nga prokurimi online.
- 2) Fondi për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në shumën 4,400,000 lekë, është realizuar plotësisht në shumën **4,345,358 lekë** ose në masën **99%**. Fondi ka shërbyer për likuidimin e përfundimit të punimeve të rikonstruksionit të godinës së kësaj gjykate.
- 3) Fondi i detajuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat në shumën **1,200,000 lekë**, për përshtatjen dhe rikonstruksionin e hyrjes së godinës së gjykatës. Gjykata ka përfunduar plotësisht realizimin e këtij projekti në shumën **1,090,830 lekë**, ose në masën **91%**. Diferenca është tepërcë prokurimi.
- 4) Fondi i detajuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në shumën **700,000 lekë**, për përshtatjen e dhomës së serverit në përputhje me dokumentin “Standarde për ndërtimin e dhomës së serverit në gjykata”, hartuar nga Drejtoria e IT dhe Menaxhimit të Çështjeve të KLGJ. Fondi është realizuar plotësisht në shumën **700,000 lekë**, në masën **100%**.
- 5) Fondi i detajuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në shumën **14,608,965 lekë**, u planifikua për realizimin e punimeve të rikonstruksionit të Godinës Civile dhe Penale si dhe punimet në nivel mirëmbajtje për vendosjen e një ashensori. Gjykata ka përfunduar realizimin e punimeve në shumën **14,572,581 lekë**, ose në masën **100%**.
- 6) Fondi i detajuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me objekt realizimin e punimeve të rikonstruksionit në katin e katërt të godinës si dhe të punimeve për hidroizolim dhe taracës. Gjykata ka përfunduar realizimin e fondit në shumën **3,812,408 lekë** ose në masën **100%**.

**Projekti 21AC401** “Blerje pajisje për infrastrukturën elektronike”, janë detajuar fonde për vitin 2023 në shumën **20,000,000 lekë**, për plotësimin e nevojave me infrastrukturë elektronike (si server, switch, kompjuter, UPS serveri, UPS kompjuteri, printer, sisteme fonie, skaner, fotokopje, diktofon, harddisk, monitor) të gjykatave. Me kërkesë të KLGJ-së, me shkresën nr. 4299, datë 24.07.2023, miratuar nga MFE me shkresën nr 13654/1, datë 07.08.2023 është shtuar fondi në shumën 173,100,000 lekë në këtë produkt. Fondi i rialokuar u përdor për realizimin e projektit për regjistrimin video të sallave të gjyqit RDA, për 20 gjykatat e të gjitha niveleve. Fondi i rishikuar vjetor në shumën **193,100,000 lekë** është realizuar në shumën **186,991,200 lekë** ose në masën **97%**.

**Projekti 18AD801** “Blerje orendi dhe pajisje zyre”, janë detajuar fonde për vitin 2023, në shumën **189,100,000 lekë**. Fondi në zbatim të vendimit nr. 447, datë 24.07.2023, të KLGJ, u pakësua në shumën **173,100,000 lekë** dhe u rishpërnda nga ky projekt në projektin 21AC401 “Pajisje elektronike”. Gjithashtu me Aktin Normativ nr 6, datë 14.12.2023 u pakësua fondi në shumën **300,000 lekë**. Buxheti i rishikuar në shumën prej **15,700,000 lekë** është realizuar në shumën **14,119,278 lekë**, ose në masën **90%**. Fondi është përdorur për blerjen e pajisjeve të zyrës si karrike zyre, karrike për salla gjyqi, tavolina dhe karrike për gjyqtarë, bibliotekë, dollape metalike arshive, kondicionerë, skaner për çantat, sistem akses kontrolli, instalim sistemi automatik i fikjes së zjarrit, pompë uji, grila, perde, bateri inverteri.

**Projekti M290075 “Blerje mjete motorike”;** Fondi i planifikuar në fillim të vitit në shumën 30,000,000 lekë u pakësua më Aktin Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, në shumën 3,700,000 lekë. Buxheti i rishikuar në shumën **26,300,000 lekë**, i programuar në programin 03310, të KLGJ, është përdorur për blerjen e 10 copë automjeteve, për përmirësimin dhe rinovimin e mjeteve të transportit në sistemin gjyqësor. Fondi është realizuar tërësisht në shumën **26,289,600 lekë**, ose në masën 100%.

Fondi, në total, në investime për programin buxhetor 03310 “Buxheti Gjyqësor”, programuar në shumën **371,600,000 lekë** është realizuar në shumën **339,108,172 lekë, ose 91%**

Në total për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” fondi në investime, programuar në shumën **386,600,000 lekë** është realizuar në shumën **351,896,516 lekë** ose në masën **91%**.

Për vitin 2023, fondi i akorduar për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është realizuar në masën **96%** kundrejt planit të rishikuar vjetor, që tregon një përdorim të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efektivitet të lartë.